



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-2020-11

Vendosi: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatës Vidar Stensland, kryegjykatës
Gjykatës Antonio Balsamo
Gjykatës Roumen Nenkov

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 7 tetor 2020

Gjuha: anglishte

Emri i dosjes: Referim lidhur me ndryshimet e propozuara të Kushtetutës së Kosovës

Klasifikimi: **Publik**

**Vendim mbi kërkesën e ZPS-së për leje për paraqitjen e
parashtrimeve**

Kryetares së Kuvendit të Kosovës
Vjosa Osmani - Sadriu

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Paneli i referohet historikut të procedurës aktuale të pasqyruar në vendimin e tij të datës 5 tetor 2020.¹ Gjithashtu, paneli rikujton se, më 24 gusht 2020, Presidenti i Kosovës propozoi një amendament të nenit 162 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Kushtetuta”), që ka të bëjë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Amendamenti i Propozuar”).²

II. REFERIMI

2. Më 18 shtator 2020, Kryetarja e Kuvendit të Kosovës i përcolli Kryetares së Dhomave të Specializuara amendamentin e propozuar, në pajtim me nenet 144(3) dhe 162(3) të Kushtetutës (“referimi”).³

3. Në veçanti, Kryetarja e Kuvendit të Kosovës i kërkoi Kryetares së Dhomave të Specializuara që t’i caktonte referimin Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, për të shqyrtuar nëse amendamenti i propozuar kushtetues nuk i pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

4. Më 22 shtator 2020, Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi panelin me përbërjen si më lart, për të marrë vendim mbi referimin.⁴

III. NJOFTIM DHE KËRKESA PËR INFORMACION

5. Më 5 tetor 2020, Paneli vendosi që t’i njoftojë autoritetet e caktuara për referimin duke iu dhënë mundësi që të paraqesin parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë, në

¹ KSC-CC-2020-11, F00004, Vendimi mbi njoftimin për Referimin dhe kërkesën për informacion, publike, 5 tetor 2020 (“Vendimi për njoftim”), paragrafët 1-8.

² KSC-CC-2020-11, F00001, A01 Amendamentet e propozuara të Kushtetutës (protokolluar më 21 shtator 2020).

³ KSC-CC-2020-11, F00001, Shkresë e Kryetares së Kuvendit të Kosovës, publike, 18 shtator 2020, me shtojcën A01 (protokolluar më 21 shtator 2020).

⁴ KSC-CC-2020-11, F00002, Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 shtator 2020.

lidhje me pranueshmërinë dhe/ose themelësinë e referimit. Paneli gjithashtu i kërkoi Presidentit të Kosovës që t'i paraqesë panelit informacion të caktuar.⁵

IV. KËRKESË PËR LEJE PËR PARAQITJEN E PARASHTRIMEVE

A. KËRKESA E ZPS-SË

6. Më 6 tetor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") kërkoi leje për paraqitjen e parashtrimeve në lidhje me pranueshmërinë dhe themelësinë e referimit. ZPS-ja bëri të ditur se është drejtpërsëdrejti e interesuar dhe se do të ketë pasoja nga referimi për amendamentin e propozuar. Konkretisht, amendamenti i propozuar ka lidhje me mandatin e ZPS-së, meqë ka të bëjë me nenin 162 të Kushtetutës i cili rregullon Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Gjithashtu, ZPS-ja ka obligim që të respektojë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.⁶

B. VLERËSIMI I PANELIT

7. Së pari, paneli rikujton se, në pajtim me rregullën 15(2) të Rregullores së Punës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, paneli mund të kërkojë informacion plotësues, ose të dëgjojë parashtrime shtesë në lidhje me referimin, në qoftë se e gjykon të nevojshme.

8. Për vlerësimin e kërkesës së ZPS-së për leje për paraqitjen e parashtrimeve, paneli merr parasysh arsyet e ZPS-së për kërkesën e vet (shih paragrafin 6 më lart).

9. Gjithashtu, paneli rikujton se, më 14 prill 2015,⁷ Gjykata Kushtetuese e Kosovës e vlerësoi amendamentin dhe i shtoi Kushtetutës nenin 162 për Dhomat e

⁵ Vendimi për njoftim.

⁶ KSC-CC-2020-11, F00005, Kërkesë e Prokurorisë për leje për paraqitjen e parashtrimeve, publike, 6 tetor 2020.

⁷ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me Shkresën nr. 05-433/DO-318, Rasti nr. KO 26/15, Aktgjykim, 14 prill 2015 (15 prill 2015), para. 9-10.*

Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, me të cilin ka të bëjë amendamenti i propozuar. Në atë aktgjykim, Gjykata Kushtetuese e Kosovës theksoi se paraqitja e Amendamentit buronte nga Shkëmbimi i Letrave midis Kosovës dhe Bashkimit Evropian i datës 14 prill 2014.⁸

10. Në këtë aspekt, paneli thekson se Shkëmbimi i Letrave i referohet themelimit të një “gjykate të specializuar” dhe një “zyre të prokurorit të specializuar” në lidhje me Task Forcën Hetimore Speciale (“TFHS”).⁹ Sa i përket TFHS-së në veçanti, neni 24(2) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) parasheh se ZPS-ja merr mandatin e TFHS-së. Gjithashtu, neni 35(10) të Ligjit parasheh se, për të siguruar vazhdimësinë e hetimeve, TFHS-ja bartet në ZPS.

11. Duke marrë parasysh sa më lart, paneli konstaton se ka arsye të mjaftueshme për të lejuar ZPS-në që të paraqesë parashtrime me shkrim në lidhje me pranueshmërinë dhe themelësinë e referimit.

PËR KËTO ARSYE, PANELI I GJYKATËS KUSHTETUESE

1. *Lejon* ZPS-në të paraqesë parashtrime me shkrim në lidhje me pranueshmërinë dhe themelësinë e referimit.
2. *Udhëzon* që parashtrimet me shkrim të paraqiten jo më vonë se 19 tetor 2020 dhe të mos tejkalojnë 10 faqe.

/nënshkrimi/

Gjykatës Vidar Stensland

Kryegjykatës

E hartuar në anglishte të mërkurën, 7 tetor 2020

Në Hagë, Holandë

⁸ Po aty., paragrafi 37; Vendimi për njoftim, paragrafët 1-3, 6.

⁹ Vendimi për njoftim, paragrafët 1-2.